



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300800/5

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandim për zbatimin e afateve ligjore dhe marrjen e masave organizative për shpejtimin e procedurave të ekzaminimit dhe hartimit të aktit të ekspertimit nga ekspertët mjeko-ligjorë me kërkesë të organeve të drejtësisë.

INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE

Tiranë

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS**

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një kërkesë shtetasi A.K me banim në Rrugën "A. Goga" Durrës, kërkesë e cila i është drejtuar njëkohësisht disa institucioneve, përfshirë këtu dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në kërkesën e tij, qytetari shprehet se, ai është viktimë e dy veprave penale, konkretisht "Kanosje për vrasje" dhe "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë", të ndodhura në qytetin e Durrësit në datat respektive 11.02.2022 dhe 16.05.2022, ku ndaj tij një person i maskuar ka qëlluar me armë zjarri, duke i shkaktuar dëmtime të rrezikshme për jetën.

Lidhur me këto dy ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me urdhrin e datës 17.05.2022 ka rregjistruar procedimin penal nr.877/2022 për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje" parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal dhe "Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit" parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal.

Në ankesën e tij ankuesi shprehet që i është drejtuar disa herë verbalisht dhe me shkresë prokurorisë për të marrë informacion për ecurinë e hetimit, por nuk ka marrë përgjigje dhe as informacion, ndonëse ka kaluar më shumë se një vit nga ngjarjet.

Në këto kushte, Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike nga administrata e pushtetit gjyqësor, iu drejtua me shkresën nr.K2/A29-2 prot.,datë 22.09.2023 “Kërkesë për informacion” organit të prokurorisë, i cili është përgjigjur me shkresën nr. 1525/1 prot., dt. 04.10.2023.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në përgjigjen e saj sqaron se procedimi penal nr.877/2022 për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, vazhdon të jetë në fazë hetimi.

Në vijim të hetimeve, bazuar në prova, veprimet hetimore proaktive, ekspertimet në funksion të hetimit, me urdhrin e datës 18.10.2022 është vendosur ndryshimi i cilësimit të veprës penale nga “Plagosje e rëndë me dashje” parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal në “Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë”, e parashikuar nga neni 78/1 i Kodit Penal.

Në shkresën e saj organi i prokurorisë sqaron se me kërkesë të prokurorit është hartuar dhe paraqitur në prokurori dhe akti i ekspertimit mjekoligjor. *Në aktin e ekspertimit mjekoligjor, eksperti ka përcaktuar se në trupin e shtetasit A.K konstatohen plagë depërtuese në kofshën e majtë pa vrimë dalëse. Dëmtimet nuk kanë qënë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit dhe pasoja është përcaktuar si plagosje e lehtë.*

Viktima e veprave penale A.K është njohur me aktin e ekspertimit dhe me kërkesën e tij është vendosur nga organi i prokurorisë ri-ekspertimi për të përcaktuar me grup ekspertësh kategorinë e dëmtimeve të marra në ngjarje.

Gjithashtu, ndër të tjera me këtë shkresë vihemi në dijeni se ende nuk është administruar nga organi i prokurorisë akti përkatës i riekspertimit mjeko-ligjor. Ky procedim penal është ende në fazë hetimi.

Vlen të theksojmë se, akti i ekspertimit mjeko-ligjor i kërkuar nga organet e hetimit penal në rastet e një vepre penale me pasoja për jetën e viktimës, konsiderohet një provë e nevojshme dhe thelbësore për ecurinë dhe zhvillimin e hetimeve. Bazuar në përcaktimet e nenit 178 të K.Pr.P “Objekti i ekspertimit”¹ si dhe në nenin 185 të K.Pr.P “Akti i ekspertimit”², kuptojmë rëndësinë që ka si provë në procesin hetimor ky akt si

¹ Në nenin 178 të K.Pr.P. “Objekti i ekspertimit” përcaktohet: **“Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore”**

² Në nenin 185 të K.Pr.P “Akti i ekspertimit” përcaktohet si vijon: “1. Mendimi i ekspertit jepet me shkrim. 2. Kur ekspertët e caktuar janë më shumë se një dhe kanë mendime të ndryshme, secili parashtron me akt të veçantë mendimin e tij. 3. Kur faktet janë komplekse dhe eksperti nuk mund të japë përgjigje menjëherë, organi procedues i jep atij një afat jo më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë. Kur ka nevojë për verifikime veçanërisht komplekse ky afat mund të zgjatet edhe më shumë se një herë për periudha jo më të gjata se tridhjetë ditë, por pa kaluar afatin maksimal prej gjashtë muajsh.”

dhe afatet e përcaktuara konkretisht në pikën 3 të nenit 185 të K.Pr.P., për hartimin dhe depozitimin e këtij akti.

Gjithashtu, “Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6745 datë 04.11.2003 e ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.7194/1 datë 24.01.2006, ka përcaktuar afatet kohore limit të përfundimit të akteve mjeko-ligjore, duke detajuar llojet e ekspertizës dhe afatet përkatëse ku harku kohor varion nga 24 orë në katër javë. Më konkretisht në nenin 59 të Rregullores parashikohet se:

“Afatet kohore limit të përfundimit të akteve mjeko-ligjore të jenë si më poshtë:

- *Akt dëshmitë mjeko-ligjore ambulatorë deri në 24 orë.*
- *Akt dëshmitë mjeko-ligjore me të dëmtuar të shtruar në spital deri në 3 ditë.*
- *Akt mjeko-ligjor të ekzaminimit të kufomave të freskëta pa ekzaminime komplementare deri në pesë ditë.*
- *Akt mjeko-ligjor të ekzaminimit të kufomave të freskëta me ekzaminime komplementare dhe atyre të dekompozuar deri në dy javë.*
- *Akt mjeko-ligjor mbi ekzaminimin e kufomave të çvarrosura ose eshtrave skeletike deri në tre javë.*
- *Akt mjekoligjor mbi dokumentat e çështjes deri në katër javë.*
- *Akt ekspertimi mbi provat biologjike deri në dy javë.*
- *Akt ekspertimi mbi provat toksikologjike deri në katër javë.*
- *Akt ekspertimi psikiatrik deri në katër javë.*

Ne raste të veçanta, tejkalimi i këtyre afateve bëhet vetëm me miratim të drejtuesit të Institucionit”.

Jo pa qëllim ligjvënësit kanë treguar vëmendje në përcaktimin e afateve të hartimit të akt ekspertimit si dhe në përcaktimin e kohës dhe vendit ku dhe kur duhet të paraqitet eksperti i caktuar me vendim të prokurorit. Konkretisht në nenin 182 të K.Pr.P, “Disponimet e organit procedues” përcaktohet se: *“1.Organi procedues disponon ekspertimin me vendim të motivuar, i cili përmban caktimin e ekspertit, paraqitjen e përmbledhur të çështjes, tregimin e ditës, të orës dhe të vendit të caktuar për paraqitjen e ekspertit.*

2. Organi procedues urdhëron thirrjen e ekspertit dhe merr masat e nevojshme për paraqitjen e personave që i nënshtrohen ekspertimit.”

Dhe në rastin konkret, prokurori i çështjes e konsideron një provë determinante si për ndërtimin e dinamikës së ngjarjes, në cilësimin e veprës penale dhe në përcaktimin e pasojës së veprës penale, por nga përgjigja, konstatojmë se ka kaluar më shumë se një vit dhe organi i prokurorisë nuk e disponon akoma këtë provë e cila duhet të paraqitet nga ekspertët e caktuar me vendim të prokurorit.

Organi i prokurorisë ndonëse janë tejkaluar afatet për paraqitjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër procedural që parashikohet në ligj në mënyrë që të administronte në afat aktin e ekspertimit, si një provë të rëndësishme dhe vendimtare për ecurinë e hetimit dhe përcaktimin e veprës penale, ngritjen e akuzës dhe përfundimin e hetimeve.

Kështu, në nenin 186 të K.Pr.P “Zëvendësimi i ekspertit” parashikohet se: “1. Eksperti mund të zëvendësohet kur nuk jep mendimin e vet në afatin e caktuar ose kur kërkesa e zgjatjes nuk është pranuar ose kur neglizhon në kryerjen e detyrës. 2. Vendimi i organit procedues për zëvendësimin jepet pasi dëgjohet eksperti. Eksperti i zëvendësuar mund të dënohet me gjobë deri dhjetë mijë lek”.

Pra, megjithëse në tejkallim të afateve, prokurori nuk ka ndërmarrë veprime as për zëvendësimin e ekspertëve të cilët nuk janë shprehur në afatin e caktuar dhe as nuk ka gjykuar për të kërkuar ndëshkimin e tyre me gjobë.

Ne vlerësojmë se koordinimi i punës ndërmjet organit të Prokurorisë dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore është shumë i rëndësishëm dhe shpeshherë determinant në procedimet penale, në dhënien e drejtësisë në kohë dhe me cilësi për qytetarin. Një drejtësi e vonuar është një drejtësi e munguar e cila nuk bën gjë tjetër veçse lëkund besimin e qytetarit të sistemi i drejtësisë dhe i hap rrugë fenomenit të vetëgjyqësisë.

Avokati i Popullit mbështet qëndrimin se aksesimi në drejtësi dhe zbatimi me rigorozitet i parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, duhet të udhëheqin punën dhe veprimtarinë e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Ndalem i dhe në një shqetësim tjetër që del nga shqyrtimi i këtij rasti, që lidhet me të drejtën e palëve për informim lidhur me ecurinë e procedimit penal. Në ankesën e tij të datës 12.09.2023, Z. K. (viktimitë e veprës penale) shprehet se “...i jam drejtuar disa herë verbalisht dhe me shkresë organit të prokurorisë për të marrë informacion për ecurinë e hetimit, por nuk kam marrë përgjigje dhe as informacion, ndonëse ka kaluar më shumë se një vit nga ngjarjet.” Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në përgjigjen e saj na informon se, me shkesën nr.1525/1 Prot.FR, datë 18.09.2023 i ka kthyer përgjigjes kërkesës së Z. K. drejtuar Prokurorisë më dt.12.09.2023.

Vlerësojmë faktin që organi i prokurorisë pas interesimit institucional të Avokatit të Popullit, i ka dhënë informacion viktimës së veprës penale por nga ana tjetër duhet të theksojmë që është shumë e rëndësishme respektimi i të drejtës së palëve për informim, si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor e cila garantohet me ligj,

Për më tepër kjo e drejtë merr rëndësi të veçantë në kuadër të qëllimeve për të cilat u implementua reforma në drejtësi e ku ndër kryesorët është rritja e besimit të qytetarëve të aksesimi në drejtësi. Për arritjen e këtij qëllimi janë përcaktuar në legjislacionin procedural në nenin 58 të K.Pr.P. “Të drejtat e viktimës së veprës penale”³ si dhe në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”⁴.

³ Në nenin 58 të K.Pr.P.” Të drejtat e viktimës së veprës penale” përcaktohet se: “ 1. Viktima e veprës penale ka të drejtë: a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale; c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar; ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi; **d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor; dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtojë kërkesa të tjera përpara organit procedues; e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod; ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit; f)**

Avokati i Popullit mirëkupton vështirësitë me të cilat po përballen aktualisht strukturat e organeve të drejtësisë për shkak të mungesave në burimet njerëzore si rezultat i zhvillimit të procesit të rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët dhe volumin e shtuar të punës për çdo magjistrat, por mbështet qëndrimin se aksesimi në drejtësi dhe zbatimi me rigorozitet i parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, duhet të udhëheqin punën dhe veprimtarinë e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Për të gjitha arsyet që parashtruam më lartë, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime*, nenin 8 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 21/b, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar”, në të cilin thuhet se: “*Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”.

REKOMANDOJMË:

- Analizimin e këtij rasti nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, lidhur me tejkalimin e afateve ligjore për hartimin dhe paraqitjen e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor bazuar në vendimin e organit të prokurorisë, duke marr masat konkrete dhe paraqitjen e menjëherëshme të tij nga ana e grupit të ekspertëve të IML-së pranë organit të prokurorisë.
- Marrjen e masave nga ana e organit të prokurorisë për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për administrimin e aktit të ekspertimit në kuadër të procedimit penal nr.877/2022, për të garantuar një proces të rregullt ligjor.
- Marrjen e masave nga ana e organit të prokurorisë për respektimin e të drejtës së palëve për informim lidhur me gjendjen e procedimit, si dhe të njohjes me aktet e provat si dhe vënien në dispozicion të një kopje të fashikullit të dosjes hetimore.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005, ku thuhet se: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo*

të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;”

⁴ Referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 3 “**E drejta e informimit**” ku përcaktohet se: “**1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuarë nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.**

3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi